**Hapet thirrja për bursa në kuadër të programit Erasmus + për personelin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin Dunarea De Jos Galati, Rumani, për të marrë pjesë në Javën Ndërkombëtare në datat 19 – 23 shtator 2022.**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për personelin me kohë të plotë të UT-së për trajnim në Universitetin Dunarea De Jos Galati, Rumani, për të marrë pjesë në Javën Ndërkombëtare në datat 19 – 23 shtator 2022.

https://en.ugal.ro/

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e personelit me kohë të plotë për trajnim (19 – 23 shtator 2022);

**Kohëzgjatja e bursave:**

- 5 + 2 ditë;

**Bursat përfshijnë:**

-Kompensim ditor (140 Eur / ditë);
-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

| **DISTANCA E UDHËTIMIT** (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm) | **Kompensimi** |
|---|---|
| **Midis 100 dhe 499 KM** | 180 EUR |
| **Midis 500 dhe 1999 KM** | 275 EUR |
| **Midis 2000 dhe 2999 KM** | 360 EUR |
| **Midis 3000 dhe 3999 KM** | 530 EUR |
| **Midis 4000 dhe 7999 KM** | 820 EUR |
| **8000 KM ose më shumë** | 1100 EUR |

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:
http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

**Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik me kohë të plotë për trajnim:**

- CV + Lista e publikimeve (për personelin akademik), (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj;
- Vetëdeklarim nëse keni kryer apo jo më parë një mobilitete Erasmus+ (nëse po, ku);
- Plani i mobilitetit për trajnim;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për trajnim klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2022/06/MA_Staff-Week-Galati.docx

*Plani i Mobilitetit për personelin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Afati për aplikim: **15 Qershor 2022**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!